

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7858  
E enjte, 8 gusht 2024  
Çmimi 0.50

### Kurti: Urat na bashkojnë, e bashkë ta bëjmë atë simbol të normalizimit



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)  
facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



EKSPERTËT AMERIKANË FLASIN PËR NGËRÇIN MES KOSOVËS DHE SERBISË

## 'PROÇESI I DIALOGUT KA HYRË NË RRUGË PA KRYE'



Profesorët amerikanë, njohës të zhvillimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë, Charles Kupchan dhe David Kanin, kanë theksuar se marrëveshjet e fundit të Serbisë me Perëndimin, ndonëse e përmirësojnë pozitën

e Serbisë përballë Kosovës, nuk duhet të interpretohen si vendosje e saj në krah të Perëndimit. Ata shprehin shqetësimet se "procesi i dialogut ka hyrë në rrugë pa krye" dhe se për këtë të dyja

palët mbajnë përgjegjësi. Kupchan është i mendimit se përmbyllja e konfliktit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të jetë në duart e udhëheqësve të të dyja vendeve dhe prirjes së tyre për të marrë vendime të vështira

### KONFIRMOHET RASTI I PARË ME VIRUSIN "ETHET E NILIT PERËNDIMOR" NË KOSOVË



### HARRIS DHE WALZ BËJNË FUSHATË BASHKË, ZOTOHEN SE DO TË 'LUFTOJNË PËR TË ARDHMEN'



### AKTUALE



### KFOR-I PARALAJMËRON SËRISH SE S'DO TË NGURROJË TË NDËRMARRË MASA PAS ZHVILLIMEVE NË VERI

### DELEGACIONI I KOSOVËS TAKON KRYETARIN E HIROSHIMËS

### SERBËT PROTESTOJNË NË MITROVICË TË VERIUT KUNDËR HAPJES SË URËS MBI IBËR

### EKONOMI



### ATK-ja: 62.4 MILIONË EURO APO 12.1 % TATIME MË SHUMË

### GËRXHALIU KËRKON RRRITJE TË PAGAVE PËR MINATORËT: MËKAT QË 'TREPÇA' ËSHTË BËRË BARRË PËR SHTETIN

### SPORT



### ARLIND BATATINA I BASHKOHET LLAPIT

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: renova@mt.net.mk  
Mobi: +377 44 501289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Harris dhe Walz bëjnë fushatë bashkë, zotohen se do të “luftojnë për të ardhmen”

WASHINGTON, 7 GUSHT - E nominuara demokrate për presidente, Kamala Harris, dhe kandidati i saj për nënpresident, guvernatori i Minesotas, Tim Walz, bënë fushatë për herë të parë së bashku më 6 gusht në Filadelfia. Në fjalimin e tij para një turme prej më shumë se 10 000 personash në Universitetin Temple, Walz tregoi për fëmijërinë e tij në një qytezë të vogël në Nebraska, për shërbimin e tij 24-vjeçar në Gardën Kombëtare Ushtarake dhe për karrierën e tij si arsimtar në një shkollë të mesme dhe trajner futbollit. “Nxënësit e mi më inkurajuan që të garoja për një post publik”, tha ai. “Ata panë në mua atë që unë shpresoja të rrenjosja te ta: angazhimin për të mirën e përbashkët dhe besimin se një person mund të bëjë dallimin”.

Gjatë fjalimit, ai, po ashtu, kritikoi të nominuarin republikan për president, Donald Trump, dhe kandidatin e tij për nënpresident, senatorin JD Vance. “Ai tallet me ligjet tona, ai mbjell kaos dhe ndarje”, tha Walz për Trumpin. “Ai u ngri gjatë krizës me Covidin, e përplasi përtokë ekonominë tonë dhe numri i krimeve të dhunshme ishte i lartë gjatë [mandatit presidencial] Donald Trumpit. Le të mos i numërojmë krimet që ai ka kryer”, shtoi Walz.

Harris hyri në garë për Shtëpinë e Bardhë pasi presidenti Joe Biden u tërhoq nga gara për rizgjedhje para pak më shumë se dy javësh.

Walz kritikoi politikën e republikanëve për kufizimin e drejtave riprodhuese të grave, një temë që po përcjell republikanët që kur Gjykata Supreme amerikane më 2022 i dha fund të drejtës kushtetuese për abort. “Edhe nëse ne nuk bëjmë një zgjidhje të tillë për vete, është një rregull i artë: shikoni punën tuaj”, tha ai, teksa kjo deklaratë u prit me ovacione nga të pranishmit.

Harris, që foli para Walzit, e paraqiti atë, duke i listuar të gjithë titujt - bashkëshort, baba, mësues, trajner, veteran, kongresist dhe guvernator dhe në fund tha se pas zgjedhjeve të 5 nëntorit, ai do të bëhet nënpresident i ri i ShBA-së. “Ai është një njeri që i bën të tjerët të ndihen mirë dhe i inspiron ata që të kenë ëndrra të mëdha”, tha ajo.

Harris tha se Walz është “një lider që mund të ndihmojë në bashkimin e shtetit tonë dhe që të lëvizim përpara si dhe është një luftëtar për shtresën e mesme”. “Fushata jonë nuk është vetëm një luftë kundër Donald Trumpit. Fushata jonë, kjo fushatë, është luftë për të ardhmen”, tha ajo.



Harris njoftoi për zgjedhjen e Walzit kandidat për nënpresident më 5 gusht.

Walz, 60-vjeçar, më 2006 u zgjodh nga një zonë me prirje republikane për t'u bërë anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan, dhe shërbeu aty për 12 vjet, para se ta fitonte pozitën e guvernatorit të Minesotas më 2018.

Walz ka çuar përpara një agjendë përparimtare që përfshin shujta falas në shkolla, synime për luftim të ndryshimeve klimatike, ulje taksash për klasën e mesme dhe rritje të numrit të ditëve të pushimit për punëtorët e Minesotas.

Trump dhe Vance e kanë kritikuar Walzin, menjëherë pasi Harris njoftoi se e kishte zgjedhur atë për të garuar për pozitën e nënpresidentit.

Sipas Trumpit dhe Vance, ai është shumë liberal. “Kjo është dyshja më radikale e së majtës në historinë amerikane”, shkroi Trumpi në platformën sociale.

Vance, ndërkaq, e kritikoi Walzin për mënyrën se si ai menaxhoi protestat pasi George Floyd, një person me ngjyrë, u vra në Mineapolis nga një zyrtar policor më 2020, duke thënë se ai nuk ishte i vendosur mjaftueshëm për t'u përballur me protestuesit.

Amerikanët gjatë zgjedhjeve

zakonisht fokusohen në kandidatin për president, por kandidati për nënpresident mund të ndihmojë apo mund ta dëmtojë kandidatin për president në bazë të të kaluarës së tyre, popullaritetit që kanë në shtetin e tyre dhe aftësisë për të fituar vota në shtete të rëndësishme apo për t'i marrë votat e votuesve të pavarur.

Pas tubimit zgjedhor në Filadelfia, Harris dhe Walz planifikojnë t'i vizitojnë edhe shtetet e tjera kyçe, përfshirë Viskonsinin, Arizonën dhe Nevadën. Vance, po ashtu, bën një turne të ngjashëm, me ndalesa që përfshijnë Miçiganin dhe Viskonsinin.

## Turqia dëshiron t'i bashkohet rastit kundër Izraelit në GjND



ANKARA, 7 GUSHT - Turqia më 7 gusht do të paraqesë një kërkesë që zyrtarisht t'i bashkohet rastit për gjenocid, të ngritur nga Afrika e Jugut, kundër Izraelit në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë.

Turqia vazhdimisht e ka kritikuar Izraelin për bombardimin e Gazës gjatë luftës kundër Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan mbështet kauzën

palestineze dhe ka dënuar “barbarinë” e Izraelit shtet që, sipas tij, “vazhdimisht ka shfaqur qëllimin e tij për të zbatuar politika masakruese”.

GjND-ja veçse ka urdhëruar Izraelin të bëjë gjithçka për ta parandaluar gjenocidin gjatë ofensivës së tij, që e nisi si kundërpërgjigje ndaj sulmit të 7 tetorit të Hamasit. Por, gjykata nuk ka urdhëruar një armëpushim. GjND-ja, po ashtu, ka urdhëruar Izraelin t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar që popullata palestineze e Gazës të ketë furnizime me ushqime

bazë dhe në maj kjo gjykatë bëri thirrje për ndaljen e operacioneve ushtarake në qytetin Rafah në jug të Gazës. “Ekipi ligjor i Parlamentit tonë më 7 gusht do të dorëzojë një kërkesë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë që t'i bashkohemi rastit”, tha Erdogan pas një mbledhjeje të kabinetit presidencial më 5 gusht. “Prandaj, ne do ta bëjmë aplikimin zyrtar në emër të Turqisë”.

Turqia është një nga shtetet më kritike ndaj veprimeve ushtarake të Izraelit në Gazë.

## “Lufthansa” pezullon fluturimet për në Lindjen e Mesme për shkaqe sigurie

Frankfurt, 7 gusht - Kompania gjermane e fluturimeve, “Lufthansa”, ka pezulluar fluturimet për në Iran, Izrael, Irak dhe Bejrut në mes të rritjes së tensioneve në Lindjen e Mesme. “Bazuar në analizat aktuale të tij të sigurisë, grupi ‘Lufthansa’ ka përshtatur sërish shërbimet e tij

në Lindjen e Mesme”, tha kompania përmes një deklaratë të publikuar më 7 gusht. “Të gjitha fluturimet për në Aman, Bejrut, Teheran dhe Tel Aviv janë pezulluar deri tani dhe përfshirë 13 gushtin”.

“Lufthansa” tha se pasagjerët mund ta ndryshojnë datën e

biletave që kanë blerë apo t'i anulojnë pa kosto shtesë.

Tensionet në Lindjen e Mesme janë rritur për shkak të luftës në Gazë në mes të Izraelit dhe Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.



# KFOR-i paralajmëron sërish se s'do të ngurrojë të ndër marrë masa pas zhvillimeve në veri

PRISHTINË, 7 GUSHT - Misioni paqeruajtës i NATO-s në Kosovë, KFOR, paralajmëroi përsëri të mërkurën se është i gatshëm t'i ndër marrë "të gjitha masat e nevojshme" për t'i luftuar zhvillimet të cilat mund ta cenojnë sigurinë dhe stabilitetin rajonal pas zhvillimeve të fundit në veri të Kosovës.

Në një komunikatë për medie, KFOR-i tha se trupat e saj patrulluan gjatë një proteste të mërkurën paradite në afërsi të urës mbi lumin Ibër në pjesën e Mitrovicës së Veriut. "Trupat e KFOR-it ishin në vendin e ngjarjes dhe kryen patrullime në zonat përreth për të garantuar një mjedis të sigurt. Demonstrata përfundoi pa ndonjë shqetësim për sigurinë", thuhet në njoftim.

Pjesëtarët e komunitetit serb protestuan të mërkurën kundër hapjes së urës mbi Ibër, pas paralajmërimit të autoriteteve të Kosovës se do ta bëjnë një gjë të tillë.

Ura mbi lumin Ibër ndan Mitrovicën e Jugut të banuar me shumicë shqiptare dhe Mitrovicën e Veriut, me shumicë serbe dhe Qeveria e Kosovës, pavarësisht prej



kundërshtimit të bashkësisë ndërkombëtare, ka thënë se synon ta hapë atë për lëvizjen e automjeteve.

Pas përfundimit të protestës, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ftoi pjesëtarët e komunitetit serb që të mërkurën të marrin pjesë në një diskutim në Mitrovicën e Veriut, në të cilin tha se mund të njoftohen "mbi përfitimet nga hapja e urës

dhe t'i shprehin shqetësimet e tyre të cilat do të trajtohen nga përfaqësuesit tanë institucionalë dhe institucionet e vendit".

Në periudhën pas luftës ura mbi lumin Ibër ishte simbol i trazirave dhe barrikadave të ngritura nga serbët e Kosovës për t'i kundërshtuar përpjekjet e Kosovës për ta vendosur autoritetin në veri. Ura, aktualisht, është e hapur

vetëm për këmbësorë, edhe pse në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë është rënë dakord të hapet edhe për qarkullimin e automjeteve.

Ditë më parë KFOR-i tha se çdo vendim për hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër duhet të merret në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi

Evropian.

Synimet e autoriteteve të Kosovës për hapjen e urës, si dhe mbyllja e nëntë objekteve të Postës së Serbisë në veri të Kosovës më 5 gusht, janë dënuar nga bashkësia ndërkombëtare dhe janë kundërshtuar ashpër nga Serbia dhe nga serbët e Kosovës.

Ushtarët italianë në kuadër të misionit të KFOR-it ndodhen në urën mbi lumin Ibër, ndërsa afër ndodhen edhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë në Kosovë, pas Policisë së Kosovës që është e para dhe pas misionit të BE-së për sundim të ligjit, EULEX, me të cilat thotë se bashkëpunon ngushtë.

## Ura e Mitrovicës

Ura kryesore mbi lumin Ibër që nga viti 1999 e ndan Mitrovicën në pjesën jugore, të banuar me shumicë shqiptare, dhe në pjesën veriore, të banuar me shumicë serbe. Vendimi për hapjen e urës është marrë në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Veriut në prill të vitit 2023, por nuk është zbatuar ende.

# Konfirmohet rasti i parë me virusin "Ethet e Nilit Perëndimor" në Kosovë



EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 GUSHT - Në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) është konfirmuar rasti i parë në Kosovë me virusin "Ethet e Nilit Perëndimor". Lajmin e ka bërë me dije Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës. "Bëhet fjalë për një pacient të gjinisë mashkullore, i lindur në vitin 1965, nga komuna e Fushë-Kosovës, i hospitalizuar në Klinikën Infektive të QKUK-së me datën 29.07.2024, për shkak të simptomave si lodhja dhe temperatura e lartë. Këto

simptoma të pacientit kanë filluar me datën 22 korrik 2024, ndërsa pas trajtimit ambulator, ai është hospitalizuar me datën 29 korrik në Klinikën Infektive të QKUK-së për evaluim dhe trajtim të mëtejshëm mjekësor. Pacienti nga data 27.06.2024 deri më 29.06.2024 ka qëndruar në Shëngjin-Shqipëri, ndërsa nga data 13.07.2024 deri më 22.07.2024 ka qëndruar për pushime në Ulqin. Simptomat i janë paraqitur menjëherë pas kthimit nga Ulqini", ka njoftuar IKShPK-ja.

Sipas IKShPK-së, pacienti është duke u trajtuar në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike

Universitare të Kosovës. "Duke qenë që prej muajit të kaluar disa vende të Bashkimit Evropian dhe të Ballkanit Perëndimor kishin raportuar raste të Virusit të Nilit Perëndimor si: Spanja, Italia, Greqia, Austria, Hungaria, Franca, Serbia dhe, së fundi edhe Shqipëria, IKShPK-së ka ngritur nivelin e vigjilencës dhe këshilluar qytetarët që të ndjekin rekomandimet e dhëna në vazhdimësi për të parandaluar rastet e Virusit të Nilit Perëndimor. IKShPK i njofton, gjithashtu, qytetarët se situata epidemiologjike është e qetë dhe po përcillet me kujdes të shtuar", thuhet në njoftimin për medie.

## Kurti: Urat na bashkojnë, e bashkë ta bëjmë simbol të normalizimit

PRISHTINË, 7 GUSHT - Kryeministri Albin Kurti ka thënë se protesta e mbajtur të mërkurën në Mitrovicë të Veriut përfundoi pa asnjë incident. Ai ka falënderuar institucionet e sigurisë që garantuan mbarëvajtjen e qetë të saj. "Protestat janë e drejtë demokratike të cilën e gëzojnë dhe mund ta ushtrojnë të gjithë qytetarët e republikës sonë pa dallim. Komuna e Mitrovicës së Veriut nesër prej orës 11:00, në hapësirat e

Kuvendit Komunal, organizon takim dhe bashkëbisedim me qytetarë, aktivistë të shoqërisë civile dhe përfaqësues të medieve lokale, me temën 'Bashkëpunimi ndëretnik, këshillim komunal për siguri në bashkësi, bashkëpunimi në mes të institucioneve dhe shoqërisë civile'. I ftoj bashkëqytetarët tanë të komunitetit serb të marrin pjesë në këtë diskutim të përbashkët në të cilin do të mund të njoftohen mbi

përfitimet nga hapja e urës dhe t'i shprehin shqetësimet e tyre të cilat do të trajtohen nga përfaqësuesit tanë institucionalë dhe institucionet e vendit", ka thënë Kurti.

Ai ka shtuar se shumë gjatë Ura e Mitrovicës mbi Ibër na ka mbajtur në distancë. "Asaj padrejtësisht i është dhënë epiteti i ndasisë dhe marrëdhënieve jonormale. Urat na bashkojnë, e bashkë ta bëjmë atë simbol të normalizimit", ka thënë Kurti.





EKSPERTËT AMERIKANË FLASIN PËR NGËRÇIN MES KOSOVËS DHE SERBISË

## “Procesi i dialogut ka hyrë në rrugë pa krye”

Profesorët amerikanë, njohës të zhvillimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë, Charles Kupchan dhe David Kanin, kanë theksuar se marrëveshjet e fundit të Serbisë me Perëndimin, ndonëse e përmirësojnë pozitën e Serbisë përballë Kosovës, nuk duhet të interpretohen si vendosje e saj në krah të Perëndimit. Ata shprehin shqetësimet se “procesi i dialogut ka hyrë në rrugë pa krye” dhe se për këtë të dyja palët mbajnë përgjegjësi. Kupchan është i mendimit se përmbyllja e konfliktit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të jetë në duart e udhëheqësve të të dyja vendeve dhe prirjes së tyre për të marrë vendime të vështira

PRISHTINË, 7 GUSHT - Muajt e fundit Serbia është angazhuar me dy shtetet kryesore të Bashkimit Evropian për arritje të marrëveshjeve strategjike. Disa ekspertë e kanë interpretuar gatishmërinë e vendeve të Perëndimit për të bashkëpunuar me Serbinë si shembull të përpjekjeve për ta joshur atë larg orbitës së Rusisë. Por dy profesorë amerikanë, njohës të zhvillimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë, Charles Kupchan dhe David Kanin, i thanë “Zërit të Amerikës” se marrëveshjet e fundit të Serbisë me Perëndimin, ndonëse e përmirësojnë pozitën e Serbisë përballë Kosovës, nuk duhet të interpretohen si vendosje e saj në krah të Perëndimit. Kupchan dhe Kanin u deklaruan për ngërçin në procesin e dialogut, qëndrimet e

kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, dhe për ndikimin që mund të kenë zgjedhjet e Shteteve të Bashkuara në rajon. Gjatë një vizite në Beograd muajin e kaluar, kancelari gjerman Olaf Scholtz nënshkroi një marrëveshje për mineralin e rrallë të litiumit, me rëndësi jetike për prodhimin e makinave elektrike. Në prill, gjatë një vizite në Francë, presidenti serb Vuçiq kërkoi të blejë nga Franca 12 aeroplanë luftarakë. Disa ekspertë dhe media botërore i kanë interpretuar këto angazhime të shtuara të Perëndimit ndaj Serbisë si shembull të përpjekjeve për ta joshur Serbinë larg orbitës së Rusisë. Për njohësit e zhvillimeve në

Serbi dhe Kosovë, profesorët Charles Kupchan nga Universiteti Georgetown dhe David Kanin nga Universiteti “Johns Hopkins”, këto marrëveshje nuk sinjalizojnë rreshtimin e Serbisë me Perëndimin. “Serbia ka qenë e suksesshme, por kjo nuk duhet të interpretohet si shenjë që Serbia ka zgjedhur Perëndimin. Nuk e ka zgjedhur Perëndimin. Vuçiqi baraspeshon Rusinë, Bashkimin Evropian, amerikanët, kinezët, turqit dhe të gjithë të tjerët me të cilët i duhet apo dëshiron të përballet dhe e bën këtë me shumë shkathtësi... Ai luan me rusët, me amerikanët. Rusët e kuptojnë këtë gjë, por amerikanët jo. Ne sillemi sikur ai e ka zgjedhur Perëndimin, ndërkohë që Rusia nuk del me deklarata të thotë se Serbia e ka zgjedhur

Perëndimin”, thotë profesori Kanin. Për profesorin e Universitetit Georgetown, Kupchan, marrëveshjet e fundit janë vazhdim i politikës që Vuçiqi po ndjek me të gjitha shtetet përkundër ndasive të tanishme gjeopolitike, që kanë vendosur Perëndimin dhe Lindjen në bosht diametralisht të kundërt. “Nuk e shoh këtë si pikë kthese dhe as shenjë se Vuçiqi po ua kthen shpinën lidhjeve të tij me Rusinë dhe Kinën dhe se po i ngul këmbët në Perëndim. Vuçiqi është i aftë të angazhohet me të dyja palët. Ai ka arritur marrëveshje me Berlinin dhe Parisin së fundmi. Besoj se do ta bëjë të njëjtën me Moskën dhe Pekinin në të ardhmen e afërt”, thotë ai. Krahas këtyre marrëveshjeve me evropianët, Jared Kushner, dhëndri i ish-presidentit dhe kandidatit të tanishëm republikan për president, Donald Trump, ka shprehur interes për një investim qindra miliona dollarësh në Beograd, për të kthyer në hotel ndërtesën e Ministrisë së Dikurshme të Mbrojtjes të bombarduar në vitin 1999 nga NATO. Serbia, e cila në vitet e fundit, në udhëheqjen e presidentit Vuçiq

ka rrëshqitur drejt autokracisë sipas organizatave të të drejtave të njeriut, ka ndjekur një politikë të marrëdhënieve më të afërta me Perëndimin, ndërkohë që ka vazhduar lidhje të afërta me Rusinë dhe Kinën. Serbia është i vetmi shtet kandidat i BE-së që nuk ka vendosur sanksione ndaj Rusisë për agresionin ndaj Ukrainës. Por Beogradi i shtet armatime ushtrisë ukrainase përmes palëve të treta. Dy ekspertët dallojnë në vlerësimet e tyre se çfarë ndikimi do të ketë ky qëndrim i Perëndimit ndaj Serbisë në dialogun me Kosovën. “Serbia sërish është shndërruar në shtetin më të rëndësishëm në rajon, që ka marrëdhënie të mira me të gjithë. Kosova, në anën tjetër, udhëhiqet nga një kryeministër me të cilin duket se askush nuk dëshiron të punojë. Dhe kjo i jep avantazh Serbisë... Para 25 vitesh, kur NATO-ja zhvillonte fushatën bombarduese, Serbia dukej si humbëse, e izoluar. Tani Serbia është gjithçka tjetër veçse humbëse, nuk është aspak e izoluar dhe ka shënuar suksese të shumta në diplomacinë që po ndjek”, thotë Kanin. Kanin, ish-analist i agjencisë amerikane të zbulimit CIA për

Ballkanin, thotë se këto suksese do t'i mundësojnë Vuçiqit të vazhdojë të këmbëngulë në krijimin e Asociacionit, i cili, sipas tij, është bërë një "obsesion" për diplomatët perëndimorë.

Kanin thotë se "vlerësimi që asociacioni do t'i integrojë serbët e Kosovës në institucionet e Kosovës është i gabuar" dhe se Serbia është në pozitë shumë të mirë që "me durim, por me këmbëngulje, të bëjë trysni për të". "Kosova është para një situatë shumë të vështirë, me një kryeministër që është jopopullor jashtë Kosovës, por që e ka të qartë që krijimi i Asociacionit do ta minojë sovranitetin e Kosovës", shton ai.

Profesori Kupchan, analist i lartë pranë Këshillit për Marrëdhëniet me Jashtë, beson që Bashkimi Evropian do të vazhdojë të përqendrohet në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por nuk mendon që Serbia do të përfitojë nga vëmendja e shtuar e Perëndimit. "Vëmendja e Perëndimit nuk besoj se forcon peshën diplomatike të Serbisë. Mendoj se Bashkimi Evropian do të vazhdojë ta nxisë dialogun midis Kosovës dhe Serbisë siç e sheh të domosdoshme. Përpyekjet e tyre janë të përqendruara në përmbylljen e këtij procesi. A do të mund të kenë marrëdhëniet më të fuqishme ekonomike ndërmjet Francës, Gjermanisë dhe Serbisë ndikim pozitiv në marrëdhënien e përgjithshme? Po, sepse

kontaktet më të shpeshta dhe lidhjet më të mëdha ekonomike janë më mirë sesa më pak, por gjithsesi nuk do t'i konsideroj këto marrëveshje si diçka që ndryshojnë rrjedhën," thotë Kupchan.

Ai thotë se ndan shqetësimet se "procesi i dialogut ka hyrë në rrugë pa krye" dhe se për këtë dyja palët mbajnë përgjegjësi. "Masat e Kurtit, ndonëse mund të qëndrojnë në aspektin politik dhe ligjor, ishin të panevojshme në aspektin strategjik, sepse ishin provokuese pa nevojë. Për shembull, vendosja e kryetarëve të komunave në veri që u zgjodhën me një përqindje të papërfillshme votash; kjo u pasua me targa të makinave dhe më vonë me çështjen e dinarit", thotë Kupchan. "Të gjitha këto veprime justifikohen, sepse Kosova po përpqet ta shtrijë sovranitetin e plotë të saj, por që nuk ishin të dobishme sa iu përket marrëdhënive me Serbinë. Beogradi nga ana e tij mobilizoi forcat përgjatë kufirit me Kosovën. Patëm një episod të dhunshëm në Banjskë dhe ai që pranoi fajësinë për këtë akt terrorizmi ende shëtitet i lirë në Serbi. Patëm pastaj një letër të kryeministres serbe e cila shprehu rezerva për marrëveshjen, në të cilën thoshte se kurrë nuk do ta njohim Kosovën. Këto janë hapa prapa dhe mund të themi se procesi i normalizimit ka ngecur", shton ai.

Muajin e kaluar qeveria

amerikane njoftoi se emëroi diplomatit Alexander Kananof të dërguar të posaçëm për Ballkanin Perëndimor pas përfundimit të mandatit të diplomatit Gabriel Escobar.

Në fillim të vitit të ardhshëm, Bashkimi Evropian pritet ta emërojë një ndërmjetës të ri për ta zëvendësuar diplomatit sllovak Miroslav Lajčak.

Kupchan, i cili ka punuar në dy administrata amerikane atë presidentit Clinton dhe të presidentit Obama, si drejtor për Evropën në Këshillin për Sigurinë Kombëtare, pret që trysnia mbi Prishtinën dhe Beogradin të rikthehet pas një pauze për shkak të zgjedhjeve në Bashkimin Evropian dhe në Shtetet e Bashkuara dhe mbetet optimist për një epilog të këtij procesi. "Mendoj se të luash me kartën e Ruisë, të Kinës, nuk është opsion në afat të gjatë për shkak të vendndodhjes gjeografike. Ballkani është pjesë e një hapësire më të madhe evropiane. Popujt e rajonit duhet të ndihen të bekuar dhe me fat. Ata që jetojnë në Azinë Qendrore, në Armeni, në Azerbajxhan, pra afër Ruisë, afër Kinës, jetojnë në një zonë të pasigurt në një të ardhme pa afat. Ballkani nuk është një zonë e tillë. Është në Evropë dhe, për pasojë, mendoj se këtij procesi do t'i vijë një fund pozitiv", thotë ai.

Por Kanan konsideron se dialogu është një proces që ka dështuar të japë rezultate dhe gjatë 30

viteve të fundit është peng i rotacionit të diplomatëve perëndimorë, që nuk kanë arritur ta çojnë procesin përpara. Sipas tij, nuk ka vullnet për të lëvizur dhe dialogu që në fillim ishte i dështuar. "Serbët e dinë këtë gjë. Kosovarët e dinë gjithashtu. Vuçiqi po blen kohë përmes avantazheve që ka siguruar përmes diplomacisë rajonale dhe kontakteve me udhëheqësit ndërkombëtarë, ndërkohë që Kurti ngul këmbë dhe provon t'i fitojë zgjedhjet e radhës dhe t'i mbajë larg serbët", thotë ai.

Sipas Kanin, Uashingtoni dhe Brukseli duhet ta rishqyrtojnë tërë qasjen e tyre ndaj rajonit dhe t'ua lënë në dorë palëve të arrijnë marrëveshje në bazë të preferencave të tyre, qoftë edhe atëherë kur zgjidhjet mund të përfshijnë plane si ai ndërmjet ish-presidentit Thaçi me presidentin Vuçiq në vitin 2018. "Ne nuk do të jemi në gjendje të imponojmë një demokraci liberale, shumetnike, transparente dhe perëndimore në rajon. Nuk do të jemi në gjendje të imponojmë paqe dhe fund të konflikteve. Kemi dështuar ta bëjmë këtë gjë gjatë tri dekadave të fundit. Mendoj se duhet t'i sfidojmë vendasit që të gjejnë mënyra për të punuar bashkërisht", thotë Kanin.

Edhe Kupchan është i mendimit që përmbyllja e konfliktit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të jetë në duart e udhëheqësve të të dyja vendeve dhe prirjes së

tyre për të marrë vendime të vështira. "Të luash me kartën e nacionalizmit është gjëja më e lehtë për ta bërë. Por, ta bindësh publikun se ka ardhur koha të lihet mënjane nacionalizmi etnik dhe të shihet drejt të ardhmes është gjëja më e guximshme që mund ta bëjnë. Nuk jemi ende tek ky moment, por mendoj se është çështje kohe. Këto pengesa do të kapërcehen kur udhëheqësit të jenë gati të hedhin hapa të guximshëm", shton ai.

A do të kenë ndikim zgjedhjet amerikane në çështjet e pazgjidhura midis Kosovës dhe Serbisë? Sipas Kupchan, në këtë cikël zgjedhor Shtetet e Bashkuara janë shumë të përqendruara në planin e brendshëm dhe politika e jashtme, e dominuar nga Ukraina dhe lufta në Gazë, nuk do të jetë përparësi por, megjithatë, pret energji të re në procesin e dialogut pas zgjedhjeve në ShBA dhe konsolidimit të zyrtarëve të lartë në BE.

Për Kanin, ndikimi do të varet nga fituesi i zgjedhjeve. Sipas tij, presidenti Trump ka treguar që është i paparashikueshëm në qasjen e tij dhe se ndryshon qëndrim, ndërkohë që, sipas mendimit të tij, kandidatja e pritshme demokrate dhe nënpresidentja aktuale Kamala Harris, për të cilën thotë se nuk di shumë për Ballkanin, ka shumë gjasa të vazhdojë të njëjta politika ndaj rajonit.



## 12-vjeçari gjen kuletën me 2 500 euro, e dorëzon në polici

SKENDERAJ, 7 GUSHT - Dymbëdhjetëvjeçari B. A. nga Skenderaj dje në orët e mbrëmjes ka gjetur një portofol, të cilin e ka dorëzuar në Stacionin Policor në

Skenderaj. Policia ka verifikuar dokumentacionin në portofol dhe ka konstatuar se, përpos dokumentacioneve të rëndësishme, në portofol gjendej

një shumë e parave prej 2 500 eurosh. Policia ka identifikuar dhe verifikuar personin të cilit i përkiste portofoli dhe ia ka kthyer atij portofolin me paratë dhe

dokumentacionin. Drejtoria Rajonale e Policisë në Mitrovicën e Jugut falënderon qytetarët për besimin dhe veprimet e ndërgjegjshme.



## Delegacioni i Kosovës takon kryetarin e Hiroshimës

PRISHTINË, 7 GUSHT - Delegacioni i Republikës së Kosovës, i cili ka marrë pjesë në ceremoninë përkujtimore në nderim të viktimave të bombës atomike, i përbërë nga ambasadori i Republikës së Kosovës, Sabri Kiçmari, kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, kryetari i komunës së Istogut, Ilir Ferati, këshilltarët e presidentes së Republikës së Kosovës, Bekim Kupina dhe Dora Musa, ka zhvilluar një takim me kryetarin e qytetit të Hiroshimës, Kazumi Matsui. Kryetari i qytetit Matsui e ka falënderuar delegacionin nga

Kosova për pjesëmarrjen në ceremoninë përkujtimore, ka vlerësuar bashkëpunimin në mes të Japonisë dhe Kosovës dhe i ka ftuar kryetarin e Drenasit dhe atë të Istogut të bashkohen në rrjetin për paqe të kryetarëve të qyteteve. Ambasadori Kiçmari e ka falënderuar kryetarin Matsui për mikpritjen, ka shprehur respektin për viktimat e bombës atomike 79 vjet më parë, ka vlerësuar lart bashkëpunimin e ngushtë politik në mes të Republikës së Kosovës dhe Japonisë dhe ka shprehur gatishmërinë për të ndihmuar në rritjen e



bashkëpunimit në mes të qytetit e Hiroshimës. Komunave të Kosovës me Kryetari Lladrovci dhe Ferati e

kanë njoftuar Matsui për gjendjen në komunat e tyre dhe e kanë mirëpritur propozimin për anëtarësim në rrjetin Kryetarët e Qyteteve për Paqe, që e ka qendrën në Hiroshima, përdërisa këshilltarja e presidentes Musa i ka përcjellë konsideratat e presidentes së Republikës së Kosovës për kryetarin Matsui dhe popullin e Hiroshimës. Në fund të ceremonisë, ambasadori Kiçmari është nënshkruar në Librin e Mysafirëve, në të cilin ai ka shprehur simpatinë për popullin e Hiroshimës dhe kryetarin Kazumi Matsui.

## Kryhet operacioni i parë për rikonstruksionin e nofullës së poshtme në QKUK, zgjati 13 orë

PRISHTINË, 7 GUSHT - Mbi 13 orë ka zgjatur një operacion që është kryer për herë të parë në Klinikën e Kirurgjisë Maksillofaciale në QKUK. Operacioni është kryer te një 28-vjeçar nga ekipi i mjekëve nga Turqia, atyre vendorë nga kjo klinikë dhe Klinika e Anesteziologjisë. Intervenimi mikrokirurgjik

është bërë për rikonstruksionin e nofullës së poshtme, pas largimit të tumorit dhe largimit subtotal të nofullës e cila ishte e dëmtuar. Kjo procedurë kirurgjike Fibula free flap nënkupton marrjen e një pjese të lëkurës, muskujve dhe kockës nga këmba dhe transferimin e



këtyre indeve në nofullën e poshtme, duke bërë

anastomosis (ngjitje) të enëve të gjakut, me enët e gjakut në kokë dhe qafë. Intervenime të tilla nuk janë kryer më parë në QKUK dhe nuk kryhen as në disa vende të rajonit. Katër kirurgjë maksillofaciale janë duke ndjekur trajnimin e avancuar për mikrokirurgji dhe free flap në Achen dhe

Bochum të Gjermanisë. Intervenime të tilla pritet të kryhen edhe në të ardhmen nga mjekët e Kosovës. Gjendja e përgjithshme e pacientit është e mirë, dhe është duke u përmirësuar. Për kryerjen e këtij rasti është shfrytëzuar mikroskopi dhe salla operative e Klinikës së Kirurgjisë Plastike.

## Përkujtohet veprimtari i shquar i çështjes kombëtare Sabit Veseli



MITROVICË, 7 GUSHT - Me rastin e 14-vjetorit të ndarjes nga jeta, përfaqësuesit komunalë e kanë përkujtuar veprimtarin e shquar të çështjes kombëtare, Sabit Veseli. Në këtë përvjetor nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, së bashku me kryesuesen e Kuvendit të Komunës, Vesa Broja, drejtorë të drejtorive komunale,

përfaqësues të Organizatave të Dala nga Lufta e UÇK-së, gjeneralin Rrahman Rama dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës, kanë bërë homazhe pranë varrit të të ndjerit në fshatin Broboniq të Mitrovicës. Gjatë homazheve nënkryetari Arian Tahiri tha se "figurën e patriotit Sabit Veseli e

përkujtojmë me nder dhe respekt të madh". "Njërin nga djemtë më të vyer të këtij vendi, më të përkushtuar e më të devotshëm të çështjes kombëtare në këto anë. I përjetshëm qoftë kujtimi për veprimtarin e shquar Sabit Veseli dhe për të gjithë dëshmorët e kombit!", është shprehur nënkryetari Tahiri.

## Prokuroria e Prizrenit për një muaj ka ngritur 166 aktakuza

PRIZREN, 7 GUSHT - Prokuroria Themelore në Prizren gjatë muajit korrik ka ngritur gjithsej 166 aktakuza kundër dyqind 212 personave për raste të ndryshme penale. Në Departamentin e Krimeve të Rënda janë ngritur 9 aktakuza kundër 10

personave. Departamenti i Përgjithshëm i kësaj prokurorie gjatë muajit korrik ka ngritur 130 aktakuza kundër 169 personave për vepra të ndryshme penale. Ndërsa nga Departamenti për të Mitur janë ngritur 27

propozime për shqiptim të masës edukative ose dënimit kundër 33 të miturve. Prokuroria Themelore në Prizren ka theksuar se mbetet e përkushtuar për luftimin e kriminalitetit, ngritjen e efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies.



# Serbët protestojnë në Mitrovicë të Veriut kundër hapjes së urës mbi Ibër

**MITROVICË E VERIUT, 7 GUSHT** - Në Mitrovicën e Veriut, pranë urës kryesore mbi lumin Ibër, kanë protestuar pjesëtarët e komunitetit serb, të cilët kundërshtuan hapjen e saj për trafik. “Në urë ne mbrojmë mbijetesën, tani mbrojmë zhdukjen”, “Nëse Kurti e hap urën, KFOR-i dhe Quint-i do të jenë përgjegjës”, “Derisa BE-ja dhe ShBA-ja po shkruajnë deklarata, neve po na dëbojnë”, ishin disa nga mesazhet që shiheshin në pankartat e protestuesve në Mitrovicë të Veriut.

Ura mbi lumin Ibër ndan Mitrovicën e Jugut me shumicë shqiptare dhe Mitrovicën e Veriut, me shumicë serbe dhe Qeveria e Kosovës, pavarësisht kundërshtimit të bashkësisë ndërkombëtare, ka thënë se synon ta hapë atë për trafik.

Gjatë protestës, ish-gjyqtari nga Mitrovica e Veriut, Nikolla Kabashiq, tha se duhet të arrihet konsensus mes të gjithë përfaqësuesve të serbëve në Kosovë për t'i identifikuar dhe mbrojtur interesat themelore të komunitetit serb. “Mjerimi është problemi ynë kolektiv. Ne jemi të sulmuar si popull, ne jemi nën agresion që të largohemi nga Kosova”, tha Kabashiq, raporton REL.

Si forma të presionit, pjesëtarët e komunitetit serb përmendën përpjekjet e qeverisë së Albin Kurtit për ta vendosur autoritetin në veri të Kosovës, si dhe praninë e pjesëtarëve të njëjve speciale të Policisë së Kosovës.

Kabashiq theksoi se nuk u protestua kundër popullit shqiptar, por kundër qeverisë së kryeministrit Albin Kurti. Duke folur synimin e Qeverisë së Kosovës që të hapë urën mbi Ibër, Kabashiq tha se komuniteti serb

nuk e dëshiron këtë, duke shtuar se pretendimet e autoriteteve e Kosovës se kjo do të bëhet për paqe dhe bashkëjetesë, nuk janë të sakta. “Ne këtu nuk ndihemi të sigurt”, tha ai, duke shtuar se ekziston liria e lëvizjes edhe pse ura nuk është e hapur për trafik. Sipas tij, ura mund të hapet vetëm nëse palët bien dakord në kuadër të dialogut për normalizimin e raporteve dhe kur situata të normalizohet. Në këtë kontekst, ai kërkoi që pjesëtarët e njëjve speciale të Policisë së Kosovës të tërhiqen nga veriu i Kosovës dhe udhëheqjen e pushtetit lokal ta marrin përfaqësuesit e komunitetit serb.

Ndërkaq Ivan Millojeviq, drejtor i Postës së Serbisë në Kosovë, tha se pret që në ditët në vijim të mbyllën degët e kësaj poste edhe në jug të Ibrit, duke shtuar se serbët duket t'iu kundërvihen autoriteteve të Kosovës “me dinjitet”.

Më 5 gusht autoritetet e Kosovës mbyllën nëntë objekte të Postës së Serbisë në veri të Kosovës, pasi punonin pa licencë. Aksioni është kritikuar nga komuniteti ndërkombëtar.

Millojeviq tha se punonjësit e Postës së Serbisë po akuzohen nga autoritetet e Kosovës për pastrim parash. “Unë kam marrë përgjegjësinë përpara punonjësve të mi dhe kam shkruar se unë personalisht duhet të akuzohem. Nëse dikush duhet të shkojë në burg, ai jam unë. Edhe nesër në urë [për të penguar hapjen] ai do të jem unë”, tha ai gjatë protestës së 7 gushtit.

Në periudhën pas luftës ura mbi lumin Ibër ishte simbol i trazirave dhe barrikadave të ngritura nga serbët e Kosovës për t'u kundërshtuar përpjekjeve të Kosovës për ta vendosur



autoritetin në veri.

Ura aktualisht është e hapur vetëm për këmbësorë, edhe pse në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë është rënë dakord të hapet edhe për trafik.

Qeveria e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në mes të korrikut njoftoi se synon ta hapë urën kryesore mbi lumin Ibër në Mitrovicë. Megjithatë vendet e Quint-it, ShBA-ja, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe Italia - më 2 gusht deklaruan se nuk e mbështesin hapjen për trafikun në këtë moment.

Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka deklaruar se çdo vendim për hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër duhet të merret në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

Ushtrët italianë në kuadër të misionit të KFOR-it ndodhen në urën mbi lumin Ibër, ndërsa afër ndodhen edhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, gjithashtu më 1 gusht përsëriti

qëndrimin e BE-së se çështja e hapjes së urës në Mitrovicë duhet të zgjidhet në kuadër të dialogut, duke pasur parasysh që për këtë ekziston një marrëveshje.

KFOR-i, gjithashtu, deklaroi se nuk do të hezitojë të reagojë nëse ekziston rreziku që ngjarjet të ndikojnë në sigurinë dhe stabilitetin rajonal.

Në protestën e 7 gushtit në Mitrovicë të Veriut ishin edhe përfaqësues të Listës Serbe, partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila ka mbështetjen e Beogradit. Kjo parti më herët kishte deklaruar se ura nuk mund të hapet pa konsultime dhe pëlqimin e shumicës serbe që jeton në anën veriore të urës.

Asamblistët e Kuvendit të Komunës së Mitrovicë të Veriut në prill të vitit të kaluar miratuan vendimin për hapjen e urës mbi Ibër, i cili më pas iu dërgua Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Nënkryetari i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Veriut,

Skender Sadiku, në fund të majit tha se për zbatimin e këtij vendimi tani janë përgjegjëse institucionet qendrore, KFOR-i dhe Bashkimi Evropian. Ai theksoi se me këtë vendim duhet të bien dakord edhe autoritetet lokale në Mitrovicë e Jugut.

Serbët në veri në fund të vitit 2022, me iniciativë të Listës Serbe, u larguan nga institucionet e Kosovës për shkak të vendimit të Qeverisë së Kosovës që targarat e makinave, të lëshuara nga Serbia, të zëvendësohen me targarat RKS - Republika e Kosovës.

Serbët, po ashtu, bojkotuan zgjedhjet e prillit të vitit të kaluar, votime nga të cilat erdhën në pushtet kryetarët shqiptarë të katër komunave në veri.

Pas presionit të komunitetit ndërkombëtar, Qeveria e Kosovës organizoi më 21 prill të këtij viti votimin për shkarkimin e kryetarëve në veri, por serbët e bojkotuan procesin pas thirrjes së Listës Serbe për bojkot. Lista Serbe kishte argumentuar se listat “nuk e pasqyrojnë gjendjen reale në terren” dhe se numri i shqiptarëve në listat e votuesve “është rritur”.

Muajt e fundit autoritetet në Kosovë kanë ndërmarrë disa vendime, sikurse vendimin për ndalimin e përdorimit të dinarit serb për kryerjen e pagesave me para të gatshme, kanë nisur mbylljen e institucioneve të Serbisë në Kosovë dhe kanë konfiskuar pronat që janë në pronësi të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Pjesëtarët e komunitetit serb gjithashtu kundërshtojnë fuqimisht shpronësimin e tokave në veri të Kosovës, të cilin po e kryen Qeveria e Kosovës për ndërtimin e stacioneve apo bazave policore.

## “Po i vrisni gratë”: Institucioneve të Kosovës u kërkohet t'i mbrojnë ato

**PRISHTINË, 7 GUSHT** - Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist ka zhvilluar një aksion simbolik pranë Stacionit Policor në Prishtinë dhe më pas pranë Prokurorisë së Shtetit, në ndërtesat e të cilëve ka shkruar “Po i vrisni gratë”.

Organizatorët e këtij aksioni thanë se në brenda pak ditë një grua në Graçanicë dyshohet se u vra nga bashkëshorti i saj, ndërkaq një ditë më parë në Ferizaj një burrë plagosi me armë zjarri gruan e tij. Nga Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist akuzuan për neglizhencë organet e drejtësisë, pasi i arrestuari për plagosjen në Fushë-Kosovë disa ditë më parë ishte ndaluar, e më pas liru për dhunë në familje. “Duke i bërë



bashkëfajtoresh institucionet e Kosovës për vrasjen e grave, ne rikujtojmë që për vajzat dhe gratë

në Kosovë çdo ditë është luftë, luftë për ta mbrojtur veten nga dhuna e gjinizuar e abuzimi

seksual, luftë për t'iu ikur plumbave dhe sëpatave. E në këtë luftë, shteti vazhdon t'ua mbajë anën dhunuesve e vrasësve, duke i amnistuar e duke e mirëmbajtur patriarkalizmin”, tha një nga organizatorët e këtij aksioni simbolik.

Kjo organizatë tha se fajëson Policinë e Kosovës, Prokurorinë dhe gjykatat, pasi “po tregojnë që ky zinxhir është patriarkal, i dhunshëm dhe armik i grave”.

Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist kërkoi që institucionet dhe shoqëria të veprojnë dhe të ndihmojnë gratë “në luftën për çlirim” dhe ta mbështesin kauzën “feministe për çlirim nga çdo lloj dhune kurdo dhe kudo”.

Sa i përket të arrestuarit për

plagosjen e gruas në Fushë-Kosovë, Prokuroria Themelore në Prishtinë sqaroi se ai ishte ndaluar më 2 gusht nën dyshimet se kishte kryer veprën penale “dhunë në familje”. Por, prokuroria tha se Gjykata Themelore në Prishtinë kishte refuzuar kërkesën për arrest shtëpiak dhe ndaj të dyshuarit I. A. ishte caktuar masa e ndalimit për t'iu afruar bashkëshortes së tij. Për këtë rast, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, akuzoi për neglizhencë institucionet e drejtësisë.

Nga viti 2010 deri në gusht të vitit 2024 në Kosovë janë vrarë 58 gra. Në të shumtën e rasteve, autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtet.

# Gërxhaliu kërkon rritje të pagave për minatorët: Mëkat që 'Trepça' është bërë barrë për shtetin

PRISHTINË, 7 GUSHT - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, ka kërkuar rritjen e pagave të minatorëve të "Trepçës" të cilët i ka quajtur "heronjtë e qëndresës dhe mbijetesës". Gjithashtu, ai ka kërkuar edhe modernizimin e teknologjisë dhe avancimin e përpunimit të metaleve.

Gërxhaliu në një intervistë për "Ekonomia Online" ka thënë se problemet e "Trepçës" duhet të zgjidhen jo vetëm me një ligj, por me zbatimin dhe implementimin e plotë të atij ligji.

Ai ka thënë se miniera e "Trepçës" është një ndër asetet më të mëdha që ka Kosova. Gërxhaliu ka theksuar se është mëkat që ky aset, i cili duhet të jetë në funksion të shtetit, është shndërruar në barrë. "Një ndër asetet më të mëdha që ka pasur Kosova në zhvillimin ekonomik është kombinati 'Trepça'. Nuk zgjidhen problemet e 'Trepçës' vetëm me një ligj, por me një implementim dhe zbatim të këtij ligji, për vetë faktin që pasuritë e 'Trepçës' janë të pakontestuara me vlera shumëdimensionale. Është një aset i cili duhet të jetë në funksion të zhvillimit të Republikës së Kosovës dhe jo të jetë barrë e shtetit të Kosovës", ka



thënë ai.

Ai ka shtuar se në kombinatin e "Trepçës" gjenden 3/4 e të gjitha elementeve kimike të sistemit periodik, gjë e cila potencon rëndësinë dhe vlerën e saj. "Heronjtë e qëndresës dhe mbijetesës së 'Trepçës' janë minatorët të cilët kanë dhënë

dhe vazhdojnë ta japin kontributin e vet në ruajtjen e këtij aseti, mirëpo nuk mjafton vetëm minatorët të bëjnë. Duhet edhe institucionet e Kosovës", ka thënë Gërxhaliu, duke shtuar se politizimi i "Trepçës" përmes bordeve dhe drejtorëve që nga paslufta e ka shndërruar atë në

barrë të shtetit. "Politizimi i 'Trepçës' përmes bordeve, drejtorëve që nga paslufta deri më sot, e ka sjellë Trepçën në këtë situatë që është shndërruar në barrë të shtetit. Mëkati më i madh është që, sipas shumë analizave në tre vitet e fundit në Kosovë, janë shpenzuar më

tepër se 520 milionë euro në forma të ndryshme të ndihmave të ndërmarrjeve publike. Ky është një mëkat që do t'i kushtojë Kosovës të ardhmen, prandaj në qoftë se sot bëjmë për 'Trepçën', ajo nesër do të bëjë për ne", ka thënë ai.

Duke folur për rëndësinë e investimit në modernizimin e teknologjisë dhe mundësitë e mëdha për eksportin e mineraleve, Gërxhaliu ka thënë se është koha kur duhet të gjendet një modalitet i mbështetjes së minatorëve. "Është koha kur duhet të motivohen minatorët dhe kur duhet të rriten pagat. Mbi të gjitha, duhet të punohet në dy dimensione të tjera: në modernizim të teknologjisë, sepse teknologjia është stërvjetruar dhe, e dyta, në avancimin e përpunimit të metaleve. Vetë fakti se nga Trepça shitet vetëm koncentrat i dhe jo metalet e përpunuara, është një dëm shumë i madh. Nga koncentrat i Trepçës, i cili eksportohet kudo në Evropë, në veçanti në Zvicër dhe në Kinë, nxirren më shumë se 31 metale të ndryshme dhe me teknologji moderne prodhohen edhe barna dhe prodhime farmaceutike", ka thënë Gërxhaliu.

## ATK-ja: 62.4 milionë euro apo 12.1 % tatime më shumë

EPOKA E FATON DËRMAKU

PRISHTINË, 7 GUSHT - Rritje e konsiderueshme e të hyrave tatimore është shënuar edhe për periudhën janar - korrik 2024, e cila është në vlerë 577.3 milionë euro. Këto shifra tregojnë rritjen e performancës në mbledhjen e të hyrave tatimore nëse bëjmë krahasimin me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, për të cilën shohim se rritja është për 62.4 milionë euro apo 12.1 % tatime. "Janë realizuar një sërë reformash strukturore dhe administrative, të cilat kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave. Digjitalizimi ose automatizimi i shërbimeve



ndaj tatimpaguesve dhe qytetarëve, përveç që ka ndikuar në rritjen e deklarimit vullnetar, ka ndihmuar edhe në rritjen e transparencës dhe efikasitetit në mbledhjen e

tatimeve", ka njoftuar Administrata Tatimore e Kosovës.

Më tutje ka theksuar se janë zhvilluar fushata intensive për ta rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe bizneseve për rëndësinë e pagesës së tatimeve dhe përfitimet që sjellin për shoqërinë tonë. "Prioritet i aktiviteteve të autoritetit tatimor mbetet luftimi dhe parandalimi i ekonomisë jo-formale, për të cilën kemi intensifikuar përpjekjet për të luftuar evazionin fiskal përmes kontrolleve më të rrepta. Këto masa kanë kontribuar në rritjen e të ardhurave nga tatimet dhe në krijimin e një klime më të drejtë konkurruese. Rezultatet e këtyre përpjekjeve

janë të dukshme. Të hyrat tatimore kanë shënuar rritje, duke kapërcyer nivelin e planifikuar dhe duke siguruar burime të rëndësishme financiare për realizimin e projekteve publike dhe përmirësimin e shërbimeve për qytetarët tanë", ka theksuar ATK-ja.

Sipas ATK-së, kjo arritje është një sinjal i qartë i angazhimit tonë për të krijuar një sistem tatimor të drejtë dhe të qëndrueshëm, i cili përbush nevojat e shtetit dhe ndihmon në zhvillimin ekonomik të vendit. "Ne si ATK do të vazhdojmë të punojmë me përkushtim për t'i zbatuar reformat e nevojshme dhe për ta përmirësuar më tej sistemin tonë tatimor", ka njoftuar ATK-ja.

## Inspektorati i Punës tashmë me zyrë edhe në objektin e komunës së Zveçanit

PRISHTINË, 7 GUSHT - Inspektorati Qendror i Punës ka filluar hapjen e zyrave në katër komunat veriore për ta siguruar respektimin e të drejtave të punëtorëve në këto komuna. Lidhur me këtë, zëvendësministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Agon Dobruna, si dhe kryeinspektori

i Inspektoratit Qendror të Punës, Hekuran Nikçi, nënshkruan marrëveshje së bashku me kryetarin e komunës së Zveçanit, Ilir Peci, për hapjen e zyrës së Inspektoratit Qendror të Punës në këtë komunë. Ndërsa pritet që së shpejti Zyra e Inspektoratit Qendror të

Punës të hapet edhe në komunën e Mitrovicës së Veriut. Vlen të theksohet që masa për punësim në katër komunat veriore mbetet e hapur dhe së bashku me mbështetjen në punësim, tashmë edhe kushtet e punës së punëtorëve do të monitorohen nga afër.





# Amerika në rënie, si Perandoria Romake?

Federico RAMPINI

Një kandidat, tashmë i dënuar në gjykatë, rrezikoi të vritej, në një episod të shënuar nga rënia e efikasitetit të Shërbimit Sekret. Kandidati tjetër hodhi peshqirin pas një presioni të gjatë për shkak të paaftësisë së dyshuar. Një parti duhet të ribëjë fushatën e saj elektorale tre muaj përpara vijës së finishit. Kandidatja e re del nga një periudhë e gjatë në hije, e rrethuar nga ana tjetër nga dyshimet për kompetencën e saj. Nivelet e popullaritetit të të gjithëve janë më të ulët e të gjitha kohërave. Vlerësimi për qeverinë dhe parlamentin është i dobët. Kush do të marrë përgjegjësinë e kombit më të fuqishëm në tokë, ndërsa dy luftëra me përmasa globale janë në prag?

## GJYKIMET E GABUARA

Fushata elektorale e vitit 2024 shfaq të gjitha defektet e Shteteve të Bashkuara, duke filluar nga e keqja që godet demokracinë më të vjetër liberale: gërryerja e besimit të institucionet dhe mungesa e një fryme të unitetit kombëtar. Si në të majtë ashtu edhe në të djathtë, mbizotëron mendimi se "Amerika është në rrugën e gabuar". Megjithatë, është republika federaliste më e vjetër në histori, një sistem presidencial shpesh i keqkuptuar, me ekuilibra dhe kundërpesha që në të kaluarën e kanë shpëtuar këtë demokraci nga rreziqet e tmerrshme.

Përfshirë momentet pas 6 janarit 2021: sulmi traumatik në Capitol Hill pati një "fund të lumtur" që u nënvlerësua në domethënie të tij.

Sociologu Robert Putnam na propozon një lojë surprizë. Fillon me një pamje të tmerrshme të të gjitha patologjive amerikane: pabarazitë, polarizimi politik, racizmi, tensionet mbi emigracionin, korrozioni i demokracisë. Kur lexuesit binden se janë përballë një përshkrimi të Amerikës sot, vjen befasia: ai tekst është një sintezë e analizave të përhapura nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë deri në fillim të shekullit të njëzetë. Domethënë, një epokë që u pasua nga përparimi më i madh amerikan në të gjitha fushat: nga ekonomia te drejtësia sociale, nga të drejtat e njeriut te arsimit, deri te ndërtimi i lidërshipt planetar.



Një ushtrim i ngjashëm mund të bëhet duke rishikuar vitet 1960. Në kujtimet tona ato shoqërohen me lëvizje të mëdha progresive: të drejtat civile të zezakëve, pacifizmin, feminizmin, çlirimin e homoseksualëve, ambientalizmin, luftërat studentore, "fëmijët e luleve", një shpërthim i krijimtarisë artistike. Në realitet, vitet gjashtëdhjetë u shënuan nga dhuna, politike e jo vetëm; nga një luftë e humbur; nga besimi i një rënieje të Amerikës, të cilën shumë amerikanë e konsideruan të merituar. Përsëri, pas asaj periudhe të trazuar, Amerika e befasoi botën me një rilindje dhe një zinxhir të gjatë suksesesh: vitet 1980 ishin plot me triumfe ekonomike, teknologjike dhe kulturore. Deri në fitoren e Luftës së Ftohtë kundër Bashkimit Sovjetik.

Historia nuk është e destinuar të përsëritet. Megjithatë, këta precedentë duhet të na këshillojnë të jemi të kujdesshëm përpara se të nxjerrim gjykime përfundimtare për rënie e Amerikës dhe dekompozimin e demokracisë së saj.

Çfarë na thotë imigrimi, për shembull, mbi arsyet e thella të hegjemonisë amerikane? Që Amerika e parë nga Jugu global

është shumë më mirë sesa mendojnë kritikët e saj. Është një tokë jo vetëm e mirëqenies materiale, por edhe e lirisë dhe e të drejtave (përfshirë të drejtën për ta akuzuar për çdo të keqe). Aspirantët e shumtë të ëndrrës amerikane ende gjejnë mundësi më të mira atje, falë një besimi në biznes dhe tek tregu, i cili në vendet e tyre të origjinës është i shtypur nga burokracitë apo despotizmat. Pavarësisht nga shenjat e besueshme se ky shekull njëzet e një është i destinuar të bëhet "shekulli aziatik", nga Kina dhe India njerëzit vazhdojnë të emigrojnë drejt Shteteve të Bashkuara dhe jo anasjelltas.

Shenjat e "kalbjes" amerikane janë reale, konkrete, shqetësuese: në plan të parë shëndeti dhe jetëgjatësia; përkeqësimi i arsimit. Megjithatë, disa janë të lidhura pikërisht me emigracionin, i cili ul në mënyrë sistematike mesataren e banorëve. Ato kompensohen nga po aq shenja vitaliteti: inovacioni i pandalur; dinamizmi ekonomik; aftësia për të kooptuar elitat e vendeve të tjera, duke përfshirë "armiqët". Simptoma më shqetësuese është rënia e vetëvlerësimit, në nivelin më të lartë tek brezat e rinj. Por diçka e ngjashme ndodhi edhe

në fillim të shekullit të njëzetë, gjatë Depresionit të Madh; dhe përsëri në vitet gjashtëdhjetë dhe shtatëdhjetë.

Ashpërsia me të cilën populli amerikan dhe pjesa tjetër e botës e gjykojnë Amerikën në mënyrë të përditshme lind gjithashtu nga një tërheqje e fshehtë: ne do të donim që ajo të ishte një model i patëmetë, një vitrinë e vlerave tona, gjithmonë në përputhje me idealat që shpall, prandaj është e destinuar të na zhgënjëjë. Në këtë fushatë elektorale të 2024-ës është pothuajse e pamundur të gesh një pikë uniteti "vlerash" midis të djathtës dhe të majtës, përveç një konvergjence pragmatike për mbrojtjen kundër Kinës dhe nevojës për të riindustrializuar vendin. Por ekziston një parim që i bashkon vërtet republikanët dhe demokratët: besimi se roli i Amerikës në botë varet nga forca e saj e brendshme, nga aftësia e saj për t'u kujdesur për veten. Teksa Amerika po lindte si komb, historiani anglez Eduard Gibbon në 1776 e përshkroi rënie e Perandorisë Romake si një alegori. Londra e tij e perceptonte veten, ashtu si Roma, si qendra e një qytetërimi mbikombëtar, globalist dhe të ndritur, bartëse e një universi vlerash dhe me misionin e

eksportimit të tyre. Pas kësaj, çdo fuqi, edhe nëse është post-moderne si Amerika e cila ka hequr dorë nga zotërimi i kolonive, në një pikë të caktuar në shëmbëlltyrën e saj historike fillon të frikësohet se do të përfundojë si Roma. Migrimet-pushtimet, rënia e shpirtit qytetar dhe vullnetit për të luftuar, ndikimi i një feje "pacifiste", korrupsioni i elitës, kriza fiskale dhe buxhetore, janë disa nga përbërësit që dalin nga faqet e Gibbon dhe kujtohen në lidhje me Amerikën sot.

Është e mundur, ndoshta e besueshme, që pesha e Amerikës në botë është e destinuar të bjerë në mënyrë të pashmangshme. Në fund të fundit, është e jashtëzakonshme: ky komb prej 350 milionë banorësh ushtron një ndikim joproporcional në shumë fusha në një planet prej 8 miliardë banorësh.

Amerikanët janë vetëm 3.5% e banorëve të planetit. As në kohën e Perandorisë Romake nuk kishte një çekuilibër kaq të dukshëm, një ndikim të kaq pak njerëzve, mbi kaq shumë të tjetër. Përballë këtij fakti – që ka zgjatur prej një shekulli – njeriu mund të admirojë ose të acarohet, të habitet ose të indinjohet: asnjëherë nuk mund të jetë indiferent. "Sette" – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## KOK-u nënshkruan kornizën për ndryshimet klimatike me Komitetin Olimpik Ndërkombëtar

PARIS, 7 KORRIK - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ka nënshkruar kornizën për ndryshimet klimatike me Komitetin Olimpik

Ndërkombëtar (IOC). Korniza është nënshkruar në Paris të Francës nga presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi dhe Nils Holmegrad nga Solidariteti

Olimpik i IOC. I pranishëm ishte edhe sekretari i përgjithshëm, Besim Aliti. KOK-u prej dy vitesh është pjesë e projektit "OCEAN" për

ndryshimet klimatike. Prej vitit të kaluar organizon edhe punëtori të ndryshme me federatat sportive dhe organizata të tjera.



## Pse i kafshojnë kampionët medaljet? Arsyeja do t'ju befasojë

PARIS, 7 GUSHT - Teksa Lojërati Olimpik po shkojnë drejt fundit, "rituali" i kampionëve të kafshimit të medaljeve vazhdon, një fenomen që është përhapur edhe në eventet e tjera sportive jashtë olimpiadave. Sekuenca e imazheve është bërë virale në mediet sociale në të cilat shohim kinezin Yaqin Zhou, e argjendtë në rrezin e grave, duke vëzhguar me habi dhe më pas duke imituar italianet Alice D'Amato (ari) dhe Manila Esposito (bronz) që synojnë t'i kafshojnë medaljet. Por nga vjen ky gjest? Teoria më e pranuar është ajo e traditës. Dikur përdorej për të kafshuar



monedha ari, një metal shumë i lakueshëm për të kuptuar në ato ishin në të vërtetë autentike, bazuar në atë se sa ishte e

mundur të gërvishteshin me dhëmbë. Megjithatë, medaljet nuk përmbajnë më shumë se disa gram ari në ditët e sotme dhe çdo komitet organizativ vendos se si t'i kompozojë të vetat. Në Paris 2024 pak nga hekuri i Kullës Eifel është i pranishëm në secilën prej tyre. Prandaj, testi i metalit nuk ka më kuptim, megjithatë ne vazhdojmë të shohim kampionët që marrin medalje nga çdo ligë. Tashmë janë kryesisht gazetarët dhe kameramanët që kërkojnë të bëhet gjesti. Krahasuar me ceremoninë e podiumit,

momenti në të cilin fituesit kafshojnë medaljen është sigurisht më dinamik dhe më i veçantë për t'u përjetësuar. Në vitin 2012 presidenti i Shoqatës Ndërkombëtare të Historianëve Olimpik, David Wallechinsky, ka thënë se fotot e kafshimit ishin "një obsesion mes fotografëve" dhe se atletët vazhdojnë ta bëjnë këtë për ta kënaqur kërkesën. Notari Summer Sanders, fitues i medalje ari, një argjendi dhe një bronz në Barcelonë më 1992, mbështeti këtë tezë: "Nuk është ideja jonë. Janë gazetarët dhe fotografët që na kërkojnë në ngulm dhe ne pranojmë".

## Latifi i jep mirënjohje sportistit Ajan Krasniqi

RAHOVEC, 7 GUSHT - Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur në takim sportin Ajan Krasniqi nga Hoça e Vogël. Latifi ka bërë me dije se Krasniqit i ka dhënë mirënjohje për arritje kulmore në sportin "Taekwondo", për përkushtimin dhe për rezultatet gjatë garave në kampionatin zviceran, si dhe për promovimin e vlerave kombëtare në mërgim. "Ishte kënaqësi të mirëpres në takim sportistin Ajan Krasniqi nga Hoça e Vogël, të cilit i dhashë mirënjohje për arritje kulmore në sportin "Taekwondo", për përkushtimin dhe për rezultatet gjatë garave në Kampionatin Zviceran, si dhe për promovimin e vlerave kombëtare në mërgim. Të rinjtë si Ajani na bëjnë krenarë kudo nëpër botë, prandaj, mirënjohja për ne është një mënyrë për të treguar vlerësimin tonë të thellë për përpjekjet dhe për sukseset e tyre. Ne do të vazhdojmë t'i mbështesim dhe t'i inkurajojmë në çdo hap të rrugëtimit të tyre!", ka shkruar Latifi në "Facebook".



## Arlind Batatina i bashkohet Llapit

PODUJEVË, 7 GUSHT - Klubi i Futbollit Llapit ka njoftuar se pjesë e këtij klubi për edicionin 2024/25 do të jetë edhe sulmuesi i ri Arlind Batatina. 18-vjeçari rikthehet në Kosovë për t'i mbrojtur ngjyrat bardhekaltër, pasi paraprakisht hapat e parë në futboll i ka marrë në Zvicër, ndërsa në sezonin e fundit ishte pjesë e

ekipit FC Köniz dhe ishte golashënuesi më i mirë i ekipit në ekipin U-19. Sulmuesi i qendrës është bashkuar me ekipin në përgatitje nga fillimi i edicionit dhe do të ketë të drejtë të paraqitet edhe për ekipin U-21, që të ketë minuta dhe të kontribuojë për ekipin për arritjen e objektivave.



## Anglia ia beson ish-lojtarit të Premierligës drejtimin e kombëtares

LONDËR, 7 GUSHT - Që kur ka përfunduar Kampionati Evropian, Kombëtarja e Anglisë ka mbetur pa selektor, pasi Gareth Southgate është larguar. Që nga ajo kohë Anglia është pa trajner. Shumë

emra kanë qarkulluar për ta marrë drejtimin e albionëve. Gjatë muajit shtator Anglia do t'i zhvillojnë dy ndeshje, ndaj Irlandës dhe Finlandës. E për këto dy duele të shtatorit, Anglinë pritet

ta drejtojë Lee Carsley, i cili aktualisht është selektor i grupmohave U21 të Anglisë. Carsley për shumë vjet ka qenë lojtar i njohur në Premierligë te skuadra e Evertonit.

Trajnerin e ri Anglia pritet ta emërojë gjatë shtatorit, por pas këtyre dy përballjeve. Eddie Howe i Newcastle United shihet si personi ideal për ta marrë drejtimin e kombëtares.



**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "SB Mineral" L.L.C. me seli në Glllogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812046945 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "SB Mineral" D.O.O. od Glllogoc, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812046945 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all customers that the limited liability "SB Mineral" L.L.C. with headquarters Glllogoc, has come to the decision to quit its business: 812046945 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "UNE" L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810170332 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "UNE" D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810170332 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all customers that the limited liability "UNE" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 810170332 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejite](https://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

**RESTAURANT****SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Zekri Rashiti shpall të pavlefshme certifikatën Murator Ndërtimtari të lëshuar nga QAP, Ferizaj me nr. 5423/19.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

